



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 30/08

Prishtinë, më 19.11.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Müfera Şinik, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, Bedri Hamza, zv.ministri i MEF-i, përfaqësues nga AKP-ja, Teki Shala nga NDI, monitorues nga OSCE, NDI, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105/1 dt. 04.11.2008 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
I ftuar: z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, njoftoi se në pikën të ndryshme është futur për diskutim edhe kërkesa buxhetore e AKP-së për vitin 2009. Më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet me plotësimin e një pike të re (kërkesa e buxhetore e AKP-së për vitin 2009).

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105/1 dt. 04.11.2008 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009
I ftuar: z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa

Kryesuesi, theksoi se buxheti për vitin 2009 i dorëzuar nga Qeveria, paraqet një material më të kompletuar dhe më të përgatitur se vitet e kaluara. Këtë e dëshmon edhe bashkëngjitja e Kornizës Afatmesme Fiskale, e cila tregon se buxheti është përgatitur konform Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi në përgatitjen e buxhetit janë përpjekur për të pasqyruar një progres dhe cilësi në realizimin e prioriteteve të përcaktuara nga Qeveria. Është paraparë një rritje reale ekonomike rreth 6%, në këtë drejtim është bërë harmonizimi i opinioneve me FMN. Rritja ekonomike si rezultat i rritjes së eksportit, investimeve dhe uljes graduale të çmimeve. Në këtë drejtim produktet vendore janë paraparë të rriten në termat nominal prej 10%, konsumi 6%. Exporti nga 419-489 milion € (17%). Importi do të jetë 2,325 miliard €. Investimet priten të jenë 1.500 miliard €. Rritje e të hyrave nga të gjitha kategoritë ekonomike (rritje nga tatimet indirekte si rezultat i ndryshimeve të skemës tatimore). Sa i përket shpenzimeve, z. Shala theksoi se shpenzimet operative janë ulur në përputhje me kërkesat e FMN-së. Është bërë rritja e të pagave të shërbyesve civil prej 10% (duke llogaritur ndryshimet në skemën tatimore pagat rriten mbi 15%), rritja e të gjitha kategorive të skemës pensionale (5€). Janë zvogëluar kërkesat e tri institucioneve kryesore (Parlamentit, Presidentit dhe Kryeministrisë), është zvogëluar rezerva e Ministrit prej 1 milion €. Në vitin vijues është paraparë kredia për KEK-un (viti fundit i subvencionimit të KEK-ut) prej 80 milion € për hapjen e minierës së Sibovcit. Kjo kredi si dhe ajo e vitit të planifikuar do të bartet në blerësin e minierave dhe projektit “Kosova e Re” me rastin e privatizimit të saj, procedura e të cilës pritet të përfundojnë në fund të vitit të ardhshëm.

Kryesuesi, theksoi në Kornizën Afatmesme, shifet se janë bërë ndryshime në politikën tatimore dhe se Projektbuxheti për vitin 2009 është hartuar duke u bazuar në këto ndryshime. Prandaj potencoi se për tu zbatuar buxheti duhet të miratohen edhe këto ligje (Ligji në të ardhurat individuale, Ligji në të ardhura të korporatave, Ligji për TVSH dhe Ligji në normën e Akcizës).

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, duke i'u përgjigjur kryetarit, theksoi se Projektligjet janë përgatitur dhe ndryshim ka të bëjë nga Rregulloret e UNMIK-ut në ligje dhe ndryshimi i normave tatimore.

Besa Gaxherri, theksoi se është e papranueshme kur ndryshimet fiskale janë bërë dhe buxheti është hartuar në bazë të këtyre ndryshimeve, ndërsa legjislacioni ende nuk është pranuar në Parlament.

Kryesuesi, njoftoi se sot nuk do të merret vendim, por vetëm diskutime dhe dhënia e informacioneve.

Bedri Hamza, zv. Ministër i MEF-it, theksoi se efekti i politikave fiskale në raport me buxhetin është neutral, ndryshon vetëm struktura e të hyrave. Kësaj here janë bërë vetëm ndryshimet në norma tatimore, ndërsa vitin e ardhshëm do të përgatiten për miratim ligjet e reja.

Riza Smaka, bëri vërejtje në mënyrën e destinimit të ndarjeve buxhetore. Shifet se disa komuna përfitojnë në mënyrë të barabartë me disa tjera (ndarja është bërë në bazë të një shablloni) edhe pse

participojnë në mënyrë disproporcionale në buxhet . Po ashtu theksoi se është dashur të jepet më shumë hapësirë dhe kujdes buxhetor ambientit. Bëri një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë, cilat janë komponentet esenciale të politikave tatimore që janë propozuar për ndryshim, duke ditur rëndësinë e madhe që kanë këto politika për shtetin dhe ekonominë e tij.

Myrvete Pantina, vlerësoi pozitivisht përgatitjen e materialit, i cili është i pasur me të dhëna krahasuese që mundëson dhënien e vlerësime reale. Megjithatë theksoi se ekziston një diferencë e madhe në vlera numerike për Bruto Produktin Vendor krahasuar me vitin 2007 (për vitin 2008 nuk ka siguruar të dhëna) si dhe dallimi në normën e rritjes në krahasim me vitin 2007, për këto kërkoj sqarime. Mungesa e ushtrimit të politikës monetare, lenë mundësinë e vetme për ndryshime në politikat fiskale të cilat janë propozuar për tu bërë dhe të cilat u shpreh se i përkrah. Megjithatë theksoi se mbështetja e disa sektorëve (në veçanti në produktet vendore) ka nevojë për përkrahje edhe më të madhe, që të ndikohet në zvogëlimin e diferencën në mes exportit dhe importit. Duke komentuar rritjen e pagave, theksoi se nëse e krahasojmë ato rritjen e inflacionit, shifet se nuk nuk do të ketë rritje reale të pagave. Lidhur me subvencionimin dhe kreditimin e KEK-ut, pyeti se a janë bazuar në pasqyrat se si janë shfrytëzua ato vitin e kaluar në mënyrë që të merret një vendim për të ardhmen.

Haki Shatri, theksoi se vështërsitë në grumbullimin e të hyrave nga dy pikat doganore 1 dhe 31, mund të reflektojnë në të hyrat e përgjithshme në buxhet. Nëse krahasojmë të hyrat nga importi (afërsisht 2,300 miliard) dhe të hyrat e realizuar nga taksat doganore (mbi 80%), pyeti pse është ky ndryshim kaq i madhë. Pyeti se a mundet të realizohet kthimi i kredisë së akorduar për KEK-un në vitin 2009. Përndryshe theksoi se mundet të bëhen disa lëvizje brenda kufijve buxhetor ndërmjet organizatave buxhetore dhe brenda të njëjtës organizatë, duke korrigjuar edhe lëshimet teknike duke mos ndryshuar skemën e përgjithshme buxhetore. Megjithatë kërkoi që të bëhet harmonizimi me FMN, përndryshe do të ketë pasoja katastrofike sidomos në realizimin e donacioneve.

Xhevdet Neziraj, vlerësoi teknikisht të përgatitur mirë buxhetin. U pajtua me mendimin e parafolësit se nëse realizohet plani gjashtë pikësh do të ketë ndikim në të hyrat doganore. Sugjeroi se do të ishte mirë që buxheti të trajtohet edhe nga komisionet tjera, në veçanti buxhetin e Ministrive që i mbulojnë. Bëri vërejtje në ndarjen e buxhetit për Komuna, që po bëhet në bazat të një shablloni. Mori shembull rastin e Komunës së Prizrenit që ka një buxhet sa dy komunat së bashku (Peja dhe Mitrovica). Lidhur me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, theksoi se shumica e projekteve janë të bartura. Në kuadër të saj është dashur të parashihen mjete edhe për të kthyerit nga diaspora. Duke komentuar parashikimin e rritjen ekonomike prej 6% u shpreh pesimist, duke ditur edhe krizën globale financiare e cila doemos do të ketë reflektim në vendin tonë. Ndërsa duke komentuar buxhetin e Ministrisë së Transportit, theksoi se investimet në rrugë lokale do të ishte mirë të iu lireshin komunave.

Besa Gaxheri, vlerësoi materialin të përgatitur teknikisht mirë. Theksoi se nga materiali shifet se nuk kemi ndonjë projekt konkret që do të ndryshonte sektorët e caktuar. Lidhur rritjen ekonomike prej 6%, nuk do të mund të ndodh. Gjithashtu nuk do të ketë rritje të pagave siç është parashikuar. Ndarja e buxhetit për disa Ministri të domosdoshme për funksionim e ligjit (Ministria e Drejtësisë, Forcës së Sigurisë dhe Punëve të Brendshme) është e vogël. Subvencioni për KEK-un i papranueshëm. Me rastin në ndarjes së investimeve kapitale nuk janë respektuar kriteret, si në nivelin lokal po ashtu edhe atë qendror. Përmendi rastin e Komunës së Pejës e cila është barazuar me buxhet me disa komuna më të vogla. Bëri vërejtje edhe në projektet e Ministrisë së Transportit, ndërtimet e reja, 40% e tyre janë planifikuar të realizohen në rajonin e Drenicës. Po ashtu nuk u pajtua me buxhetin e ndarë për Mitrovicën, i cili do të duhej të ishte më i lartë, të bëheshin projekte konkrete për atë vend. Vërejtje bëri për rritjen e numrit të punëtorëve në Ministrinë e Shëndetësisë

(numër i barabartë në regjionin e Pejës me Gjakovën). Ndërsa në Ministrinë e Shërbimeve Publike nuk ka projekte konkrete për investimet kapitale. Po ashtu vërejtje bëri ndarjes së buxhetit të vogël për Ministria e Bujqësisë. Në përfundim theksoi se po të respektohej renditja e prioriteteve të paraqitura në Kornizën Afatmesme, do të mund të realizohej më lehtë buxheti, por ajo nuk është bërë.

Kosara Nikolić, theksoi se me rastin e analizës së buxhetit ka vërejtur se secila Ministri ka rritje krahasuar me vitin e kaluar, përpos Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Gjithashtu theksoi se me rastin e ndarjes së investimeve kapitale nuk është respektuar kriteri i paraparë me Kushtetutë, për investime për komunitete prej 10-12%. Theksoi se do të duhej që të gjitha Ministrinë të respektonin kriterin e përqindjet e garantuara me Kushtetutë dhe ligje në realizimin e investime kapitale për komunitetet, e jo vetëm Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Hajdin Abazi, vlerësoi projektbuxhetin të përgatitë mirë. Bëri vërejtje për buxhetin e ndarë për Komunën e Junikut i cili do të duhet të ishte më i madh (kur dihen dëmet e pësuar nga lufta). Përsëriti vendimin e Qeverisë për ndryshimin e skemës tatimore. Megjithatë kërkoj një sqarim propozimin për uljen e tatimit të korporatave në 10%, kur dihet se ndryshimet e tilla do të ndikonin në stimulimet indirekte për investimet nga jashtë.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi të përgatitë mirë dokumentin e projektbuxhetit konform standardeve. Në këtë drejtim vlerësoi edhe bashkëngjitjen e Kornizës Afatmesme Fiskale si dhe propozimet për ndryshimet fiskale, të cila japin një pasqyrë më të qartë për të ndikuar në investimet nga jashtë. Fondet janë kanalizuar mirë konform politikave prioritare të qeverisë. Vlerësoi përpjekjet në uljen e shpenzimeve joproduktive dhe në anën tjetër rritjen e investimeve kapitale (arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, etj). Sa i përket ndarjeve për komuna theksoi se nga ajo që ka analizuar, ka parë se nuk janë bërë diferencime dhe se është respektuar Ligji mbi menaxhimin e financave lokale. Nga buxheti i komunave shifet se ka një rritje të buxhetit të tyre krahasuar me vitin 2008. Nga materiali shifet se edhe realizimi i buxhetit të tyre është më i mirë dhe se ndarja e buxhetit të komunave për vitin 2009 është bërë duke respektuar edhe këta faktorë. Sa i përket pjesës tekstuale është dukshëm më e mirë, pasqyrim i qartë i rrjedhës së menaxhimit të mjeteve. Me buxhetin e vitit 2009 për herë të parë po bëhen lëvizje në rritjen e pagave të shërbyesve civil, poashtu vlerësoi pozitive edhe parashikimin për rritjen modeste e pensioneve. Prandaj sipas z. Hadërgjonaj ka një arsye për të votuar këtë projektbuxhet sepse ai ka refleksione në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, duke iu përgjigjur pyetjeve për buxhetin e paraparë për komunat theksoi se është respektuar Ligji mbi menaxhimin e financave lokale. Problem regjistrimi i popullsisë në ndarjet buxhetore komunale. Nga ajo që është prezantuar shifet se ka dyfishim të buxheti për secilën komunë. Ndërsa në pyetjen e znj. Nikolic theksoi se ndarja për minoritete është bërë duke respektuar ligjet përkatëse.

Kryesuesi, theksoi se një çështje e veçantë ka të bëjë me buxhetin e agjencioneve të pavarura, i cili problem duhet zgjidhur bashkarisht me MEF-in.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni i rekomandon Kuvendit që në leximin e parë të miratojë në parim Projektligjin nr. 03/L-105 për Buxhetin e Konsoliduar dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009.

- II. Komisioni kërkon që me rastin e shqyrtimit dhe miratimit në parim të Projektligjit nr.03/L-105 për Buxhetin e Konsoliduar dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009, të shqyrtohen dhe miratohen në parim edhe Projektligji për Normën e Akcizës në Kosovë nr. 03/ L-112, Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave nr.03/L-113, Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nr.03/L-114 dhe Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Individuale nr.03/L-115.

3. Të ndryshme

Kryesuesi, kërkoj sqarime nga përfaqësuesit e AKP-së lidhur me kërkesën e tyre.

Avni Jashari nga AKP- theksoi se buxheti i paraparë për AKP nga MEF nuk është i mjaftueshëm për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e paraparë për vitin vijues. Kjo kur dihet bartja e përgjegjësiave në sferën e privatizimit nga UNMIK-u, shpenzimet në ndërmarrjet me spin of special si dhe pensionet për punonjësit e AKP-së të cilat në fakt janë aprovuar nga MEF-i..

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, vlerësoi si të rëndësishëm ecjen e privatizimit. Ndarja buxhetore është bërë konform mundësive që kemi pasur. Çdo ndryshim në buxhet që mund të bëhet, në bazë të rialokimeve në mes agjencioneve buxhetore. U pajtua me mendimin se duhet munduar të bëhen harmonizimet e qëndrimeve për të plotësuar kërkesat buxhetore të këtij agjencioni.

Kryesuesi, theksoi se nëse mendohet të jetë funksional atëherë duhet shikohet mundësi e harmonizimit të kërkesës. Duhet së bashku me MEF-in të shikohet mundësia e lëvizjeve të brendshme të buxhetit, të bëhen propozimet për të cilat duhet vendos Kuvendi.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni konstatoi se në mes periudhës së leximit të parë dhe të dytë të Projektligjit nr. L-105/1 dt. 04.11.2008 për Buxhetin e Konsoliduar dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009, në bashkëpunim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa do të bëjë harmonizimin e kërkesës buxhetore dt.13 nëntor 2008 të AKP-së për vitin fiskal 2009

Kryesuesi, njoftoi anëtarët për një takim të caktuar me GTZ për të diskutuar për mundësitë të ofruar nga ata për të ndihmuar në këtë fazë të procesit buxhetor. Prandaj i ftoi që të marrin pjesë në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI